



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## KPA VENDOS TË MOS HETOJË DENONCIMET E QYTETARËVE NDAJ ALMA BRATIT

---

Të premten datë 26 Prill u zhvillua seanca gjyqësore e Znj Alma Brati, Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në çelje të seancës gjyqësore subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të mos marrë në konsideratë denoncimet e paraqitura në seancën e kaluar, duke i cilësuar të pavërteta dhe absurde sepse ishin uploaduar në të njëjtën ditë, orë, sekondë në faqen zyrtare të denoncimeve. Gjithashtu nuk përmbushnin kushtet e një dokumenti të rregullt ligjor, nuk përmbanin as vulë as nuk ishin të noterizuara.

Znj. Alma Brati parashtroi argumente dhe në lidhje me përmbajtjen e denoncimeve, denoncuesit me iniciale B.T dhe K.Ç. kanë paraqitur të njëjtin dokument identik, dhe kanë shtrembëruar qëllimisht të dhënat financiare në këto denoncime duke konvertuar Liretat në Euro dhe duke dhënë përshtypjen e një shume kredie më të madhe se kredia reale. Shuma e marrë kredi ishte 110 milion lireta dhe ishte paraqitur si 110 mijë euro, ndërsa në fakt shuma duhej të ishte konvertuar në 56 mijë euro. Për sa i përket njërit nga denoncuesit (B.T), Subjekti i rivlerësimit u shpreh gjatë seancës se denoncuesja ka qenë këshilltare e Kolegjit, fakt që përbën një shkelje të hapur të ligjit për ruajtjen e të dhënave personale dhe atë të konfidencialitetit nga ky subjekt.

Gjithashtu subjekti i rivlerësimit parashtroi se të afërmit e saj kanë pasur mundësi financiare për të paguar këstet e kredisë dhe po ashtu edhe për të kursyer. Të dhënat financiare të çiftit (M.P dhe L.P) që i kishte huazuar asaj 25 mijë euro kishin qenë të besueshme edhe për bankat italiane që u kishin dhënë atyre kredi tjetër.

Znj. Brati kërkoi po ashtu nga KPA që të merrte 2 prova të reja; shkresë nga ISSH Drejtoria Rajonale Lezhë, Dega Arkiv për vjetërsinë në punë të nënës së saj, dhe një shkresë për babain e saj. Subjekti pretendoi pasaktësi të të dhënave nga institucionet publike, pasi ishte bërë një gabim në emrin e babait të subjektit të rivlerësimit.

Znj Brati kërkoi në fund të seancës, mbylljen e hetimit gjyqësorë dhe konfirmoi se ishte gati për parashtrimet përfundimtare.

Komisioneri Publik nga ana tjetër kërkoi që denoncimet të merreshin parasysh duke thënë se ato ishin të rëndësishme për sa i përket analizës së pasurisë së subjektit.

Trupi gjykues kërkoi shtyrje seance për në orën 13.00, por morën me shumë kohë, rreth 50 minuta për fillimin e seancës, ku dhanë vendimet e ndërmjetme si më poshtë:

1. Të pranojnë provat e reja të subjektit të rivlerësimit;
2. Të mos hapin hetim gjyqësor mbi dy denoncimet e paraqitura;
3. Shtyrjen e seancës me 22 Maj ora 10.00 për të marrë kohë për të kryer një tjetër analizë financiare.